



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Priljeno: 27.01.2026		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
05-020/04-4166		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Neni 8 të Rregullores mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve nr. MF04/2017 si dhe neni 51 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 24.12.2021, Drejtoresha e DKRS shpallë:

NJOFTIM PUBLIK

Për dërgimin e propozimeve për anëtar në komisionin vlerësues për Implementimin e strategjisë për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në Komunën e Lipjanit, si dhe implementimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal 2025-2027

Njoftohen përfaqësuesit e Organizatave të shoqërisë civile se mund ti dërgojnë propozimet e tyre për plotësimin e Komisionit Vlerësues i cili do të formohet me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve të financimit të projekteve, të OJQ-ve të cilat do të aplikojnë sipas thirrjes publike për aplikim me Nr.05-453/01-469 të datës 06.01.2026.

Ky Komision do të formohet me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve për financimin e projekteve që kontribuojnë në Kulturë dhe Rini në Komunën e Lipjanit, sipas thirrjes publike për aplikim të Nr.05-453/01-469 të datës 06.01.2026ku do të plotësohet me:

- Një përfaqësues nga OJQ-të
- Një përfaqësues nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit

Propozimet tuaja do të jenë të mirëpritura dhe duhet t'i drejtohen Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport dhe të njëjtat të dorëzohen në ndërtesën e Komunës kati I në Qendrën për shërbime me qytetar sporteli nr. 1 dhe 2 më së largu deri me datë **02.02.2026**.

Lipjan, më 27.01.2026

Burim Rrustemi

Drejtor-DKRS

